LIGJ
Nr.9326, datë 6.12.2004

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, bëhen këto ndryshime e shtesa:

Neni 1
Pika 5 e nenit 8/1 shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 9, tabela nr.1, që i bashkëlidhet ligjit në fuqi, zëvendësohet me tabelën nr.l, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 3

Në pikën 1 të nenit 10, fjalët "data 15" zëvendësohen me fjalët "data 20".

Neni 4

Në fund të pikës 1 të nenit 11 shtohen fjalët si më poshtë:
“ndërsa pasuritë e paluajtshme, tokë bujqësore, tatohen në masën 0,5 për qind të çmimit të shitjes.”.

Neni 5

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 13
Deklarimi

1. Çdo individ, që realizon të ardhura nga çdo burim, i përcaktuar në nenin 8, për të cilat nuk është mbajtur tatim në burim, në zbatim të dispozitave të tjera të këtij ligji, duhet t’i deklarojë këto të ardhura në organin tatimor jo më vonë se 30 janari i vitit pasardhës.

2. Tatimpaguesi, sipas pikës 1 të këtij neni, bën pagesën e detyrimit në bankë me dokumentin e pagesës së lëshuar nga organi tatimor.

3. Në përputhje me fazat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni, çdo individ, që realizon të ardhura, pavarësisht nëse këto të ardhura janë tatuar apo janë ose jo të tatueshme, duhet të paraqesë në organin tatimor përkatës deklaratën tatimore integrale për të ardhurat personale, të realizuara nga çdo burim, jo më vonë se 28 shkurti i vitit pasardhës. Modeli i deklaratës integrale të të ardhurave personale do të përcaktohet në një udhëzim të posaçëm të Ministrit të Financave.

4. Detyrimi për të deklaruar, sipas pikës 2 të këtij neni, zbatohet në fazat e mëposhtme:

a) në fazën e parë, për të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2005 e në vijim, pronarët dhe administratorët e shoqërive (tregtare), personat fizikë, të regjistruar si subjekte të tatimit të thjeshtuar

mbi fitimin, drejtuesit e ndërmarrjeve shtetërore dhe drejtuesit apo pronarët e fondacioneve ose organizatave jofitimprurëse duhet të dorëzojnë deklaratën integrale;

b) në fazën e dytë, për të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2006 e në vijim, të gjithë punonjësit që gëzojnë statusin e nëpunësit të shërbimit civil duhet të dorëzojnë deklaratën integrale;

c) në fazën e tretë, për të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2007 e në vijim, të gjithë të punësuarit e institucioneve buxhetore, të ndërmarrjeve shtetërore apo private, të fondacioneve dhe të vetëpunësuarit ose të punësuarit në subjektet e biznesit të vogël, duhet të dorëzojnë deklaratën integrale.

Neni 6

Pas shkronjës "dh" të nenit 18 shtohen shkronjat "e" dhe "ë" me këtë përmbajtje:

"e) fondacionet ose institucionet financiare jobankare, të krijuara ose të transferuara me vendim të Këshillit të Ministrave, që kanë për qëllim mbështetjen e politikave zhvilluese të Qeverisë nëpërmjet dhënies së kredive;

ë) shtëpitë filmike, të prodhimit kinematografik, të licencuara dhe të subvencionuara nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë.".

Neni 7

Në nenin 21 bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

1. Shkronja "ë" e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"ë) interesat e paguar, të cilët tejkalojnë normën mesatare të interesit 12-mujor të kredisë për tregun bankar, sipas publikimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë.".

2. Pas shkronjës "ll" të pikës 1 shtohet shkronja "m" me këtë përmbajtje:

"m) humbjet, dëmtimet, firot dhe skarcot gjatë prodhimit, tranzitimit dhe magazinimit, tej normave të përcaktuara në akte të veçanta, ligjore dhe nënligjore.".

3. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Nëse gjatë periudhës tatimore, huaja dhe parapagimi tejkalojnë mesatarisht katër herë shumën e kapitaleve të veta, interesi i paguar për shumën e tejkaluar nuk njihet si shpenzim i zbritshëm. Ky kufizim nuk zbatohet për bankat dhe shoqëritë e sigurimeve.".

Neni 8

Neni 28 "Shkalla tatimore" ndryshohet si më poshtë:

"Neni 28
Shkalla tatimore

Shkalla tatimore e tatimit mbi fitimin për vitin fiskal 1 janar deri më 31 dhjetor 2005 është 23 për qind dhe për vitet e tjera fiskale 20 për qind.".

Neni 9

Pika 3 e nenit 29 shfuqizohet.

Neni 10

Në fund të shkronjës "b" të nenit 32 shtohen fjalët "për çdo muaj vonesë”.

Neni 11

Shkronja "c" e pikës 2 të nenit 32/1 shfuqizohet.

Neni 12

Pika 1 e nenit 32/2 ndryshohet si më poshtë:

"1. Të gjithë tatimpaguesit regjistrohen vetëm një herë, në çastin e fillimit të veprimtarisë ekonomike, para se të fillojnë biznesin. Përjashtimisht për vitin 2005, tatimpaguesit e taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe/ose të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, riregjistrohen brenda datës 20 mars. Në rastet kur tatimpaguesit nuk regjistrohen ose nuk riregjistrohen në kohën e duhur, degët e tatimeve bëjnë regjistrimin e tyre dhe ky regjistrim do të ketë të njëjtat efekte si regjistrimi i bërë nga vetë tatimpaguesit.".

Neni 13

Neni 32/3 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 32/3

1. Shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është 3 për qind.

2. Tatimi llogaritet mbi shumën e qarkullimit të realizuar gjithsej gjatë një viti kalendarik ose pjese të tij.".

Neni 14

Neni 32/6 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 32/6

Pagesa

1. Tatimpaguesi paguan këstet e detyrimit vjetor në bazë të qarkullimit të vlerësuar për vitin kalendarik. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, llogaritja e qarkullimit të vlerësuar për vitin kalendarik bazohet në qarkullimin faktik të vitit të kaluar, në parashikimet e vetë tatimpaguesit dhe në vlerësimet e bëra nga dega e tatimeve. Tatimpaguesi paguan tatimin e thjeshtuar mbi fitimin në këste si më poshtë:

a) jo më vonë se datat 20 prill, 20 korrik dhe 20 tetor, përkatësisht, për tremujorin e parë, të dytë dhe të tretë të vitit ushtrimor;

b) jo më vonë se data 20 dhjetor për tremujorin e katërt të vitit ushtrimor;

c) diferencat e mundshme, që lidhen me ndryshimin e xhiros së realizuar në fakt gjatë vitit me atë të paguar, deklarohen dhe paguhen në çastin e paraqitjes së deklaratës vjetore, të përcaktuar në nenin 32/4 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe sistemohen në çastin e pagesës së këstit të parë të vitit pasardhës.

2. Kur një biznes fillon gjatë një periudhe të tatueshme, llogaritja e kësteve bazohet në qarkullimin e vlerësuar, sipas parashikimeve të bëra nga vetë tatimpaguesi dhe në vlerësimet e bëra nga dega e tatimeve. Pagesa kryhet në përputhje më afatet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, për kohën faktike të ushtrimit të veprimtarisë.

3. Kur tatimpaguesi dorëzon një deklaratë për ndërprerjen e veprimtarisë, sipas nenit 32/4 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, pagesa e tatimit bëhet jo më vonë se 10 ditë nga data e dorëzimit të deklaratës. Procedurat për deklarimin e ndërprerjes së veprimtarisë dhe rifillimin e saj përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

4. Tatimi i mbledhur derdhet në Buxhetin e Shtetit dhe i transferohet një herë në muaj buxhetit të bashkisë ose komunës, ku tatimpaguesi është regjistruar ose ka vendndodhjen e biznesit. Procedurat për transferimin e fondeve dhe shkëmbimin e të dhënave janë të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.".

Neni 15

Në nenin 32/8 të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja "a" e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"a) kur tatimpaguesi nuk regjistrohet ose nuk riregjistrohet, në përputhje me kërkesat e nenit 32/2, dënohet me 35 mijë lekë gjobë;".

2. Pas shkronjës "d" shtohet shkronja "dh" me këtë përmbajtje:

"dh) kur tatimpaguesi nuk paraqet deklaratën vjetore të qarkullimit, dënohet me 10 mijë lekë gjobë.".

Neni 16

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 33

Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat

1. Të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, i njohur nga legjislacioni në fuqi, janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim në masën 10 për qind nga shuma bruto e pagesave të mëposhtme, që lindin nga një burim në Republikën e Shqipërisë:

a) dividendët;

b) ndarjet e fitimit;

c) interesat;

ç) pagesat për të drejtat e autorit dhe për pronësinë intelektuale;

d) pagesat për shërbimet teknike, shërbimet e menaxhimit, shërbimet financiare dhe ato sigurimit;

dh) pagesat për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues;

e) pagesat për ndërtimin, instalimin, montimin ose për punë mbikëqyrëse, që lidhen me to;

ë) pagesat për qiratë;

f) pagesat për shfaqjet e aktorëve, të muzikantëve ose të atletëve, përfshirë pagesa të tilla që u bëhen personave, të cilët punësojnë artistë ose atletë apo ndërmjetësojnë për shfaqjet e tyre.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për:

a) personat rezidentë shqiptarë, të regjistruar si tatimpagues të tatimit mbi fitimin dhe të tatimit mbi vlerën e shtuar ose personat e regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël;

b) dividendët dhe shpërndarjet e tjera të fitimit brenda objektit të përcaktuar në nenin 26 të këtij ligji;

c) pagesat e bëra personave jorezidentë për shërbimet për transportin ndërkombëtar të pasagjerëve dhe mallrave.

3. Përveç rasteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, tatimi në burim i mbajtur mbi pagesën, sipas pikës 1 të këtij neni, përfaqëson detyrimin tatimor përfundimtar.

4. Tatimpaguesi subjekt i tatimit mbi fitimin, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti detyrohet të miratojë rezultatet financiare të vitit paraardhës.

a) Shoqëritë tregtare duhet të depozitojnë pranë organeve tatimore, jo më vonë se data 31 korrik, vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë, për përdorimin e fitimit pas tatimit të vitit paraardhës. Përdorimi i fitimit ose i një pjese të tij për rritjen e kapitalit themeltar, për rezerva ligjore e statutore dhe mbartja e fitimit, nuk konsiderohen shpërndarje e dividendit.

b) Shoqëritë tregtare nëse nuk kanë depozituar pranë organeve tatimore deri më 31 korrik vendimin e organit kompetent vendimmarrës për përdorimin e fitimit të vitit paraardhës, fitimi pas tatimit, pa përfshirë rezervat e domosdoshme ligjore, për efekte tatimore, konsiderohet dividend për t'u shpërndarë dhe tatohet në masën 10 për qind. Në këtë rast tatimi derdhet nga shoqëria në favor të organeve tatimore brenda datës 15 gusht të periudhës tatimore në vazhdim.

c) Çdo zvogëlim kapitali, që nuk ka për qëllim mbulimin e humbjeve dhe që nuk përbën

kontribut në para të pronarëve, konsiderohet dividend i tatueshëm. Në këtë rast, tatimi mbahet në burim dhe derdhet nga shoqëria në favor të organeve tatimore brenda 15 ditëve nga data e marrjes së vendimit për zvogëlimin e kapitalit.

5. Pa cenuar dispozitat e mësipërme të këtij neni, për Agjencinë Ndërkombëtare të Transportit Ajror (ANTA) paguhet tatim në burim në masën 10 për qind si tatim i posaçëm për të ardhurat nga shërbimet navigacionale ajrore. Ky tatim llogaritet nga ANTA mbi arkëtimet bruto nga EUROKONTROLLI dhe paguhet në organin tatimor jo më vonë se 15 ditë nga çasti i arkëtimit të tarifave përkatëse nga EUROKONTROLLI.”.

Neni 17

Në pikën 1 të nenit 35 fjalët "data 15" zëvendësohen me fjalët "data 20".

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4430, datë 17.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

TABELA NR.1
TABELA PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT PERSONALE NGA PUNËSIMI

E ardhura e tatueshme (në muaj)	TAP		Përqindje
Mbi (lekë)	Deri në (lekë)	Lekë	
0	14 000		Pragu përjashtues
14 000 +	40 000	0	+ 5% të shumës mbi 14 000 lekë
40 000 +	90 000	1 300	+ 10% të shumës mbi 40 000 lekë
90 000 +	200 000	6 300	+ 15% të shumës mbi 90 000 lekë
200 000 +	500 000	22 800	+ 25% të shumës mbi 200 000 lekë
500 000 +	Më tepër	97 800	+ 30% të shumës mbi 500 000 lekë